



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.8, datë 16.03. 2017

Për

**“Shqyrtimin e ankimit administrativ të sipërmarrësit Arsen Shahaj, person fizik, Mbi
Vendimin Përfundimtar të Inspektimit nr.15, date 27.02.2017”**

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Z. Alban	Karapici	Anëtar
3. Zj Anila	Denaj	Anëtar
4. Zj. Ketrin	Topçiu	Anëtar
5. Zj. Klarina	Allushi	Anëtar

dhe sekretare Znj. M.Drushku, në mbledhjen e datës 16.03.2017, në mbështetje të nenit 114 dhe nenit 115 në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe Rregullores së Brendshme të Funkcionimit të Këshillit Drejtues të AKEP, miratuar me Vendimin Nr.7, datë 16.02.2017 të Këshillit Drejtues të AKEP, shqyrtoi sipas procedurës së përcaktuar në nenin 136 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, çështjen me objekt:

**“Ankim administrativ i sipërmarrësit Arsen Shahaj, person fizik, mbi Vendimin
Përfundimtar të Inspektimit nr.15, date 27.02.2017”**

BAZA LIGJORE:

1. Neni 132 e vijues të ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (**ligji nr. 9918**);
2. Neni 46 e ligjit nr.10433, datë 16.06.2011 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë (**ligji nr.10433**);
3. Neni 130 e vijues të ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” (**ligji nr. 44/2015**);
4. Rregullores Nr.46 “Metodika e Inspektimit të Veprimtarisë së Sipërmarrësve të Rrjeteve dhe të Shërbimeve të Komunikimeve Elektronike”, miratuar me Vendim Nr.2695, datë 27.10.2016;

5. Rregullores “Mbi masat teknike dhe organizative për të garantuar sigurinë dhe integritetin e rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike” miratuar me Vendim Nr.37, date 29.10.2015;
6. Rregullore e Brendshme të funksionimit të Këshillit Drejtues të AKEP, miratuar me Vendimin Nr. Nr.7, datë 16.02.2017 të Këshillit Drejtues të AKEP;

K Ë S H I L L I D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

1. Ankesën e sipërmarrësit “Arsen Shahaj”, person fizik, me shkresë nr.682/4 prot. datë 09.03.2017;
2. Relacionin shpjegues për shqyrtimin e ankimit;
3. Projekt - Aktin, Mbi shqyrtimin e ankimit administrativ të z.Arsen Shahaj, person fizik, lidhur me Vendimin Përfundimtar të Inspektimit Nr.15, datë 27.02.2017;
4. Autorizimin e Inspektimit, shkresë Nr.682 prot. datë 13.02.2017;
5. Njoftimin për Autorizimin e Inspektimit, shkresë me Nr.682/1 prot. datë 16.02.2017;
6. Procesverbalin e Inspektimit nr.77, datë 14.02.2017, shkrsë Nr.682/2 prot. datë 02.03.2017 dhe gjobë nr.66, datë 27.02.2017;
7. Vendimin Përfundimtar të Inspektimit, shkresë Nr.682/3 prot. datë 02.03.2017;
8. Komunikime me e-mail me sipërmarrësin Arsen Shahaj.

V Ë R E N:

I. Në aspektin formal:

Ankimi është paraqitur brenda afatit ligjor të parashikuar dhe sipas formës së përcaktuar në nenin 136 dhe 140 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Proçedurave Administrative”, nenit 132 e vijues të ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe në pikën 3.9 të Rregullores Nr.46, datë 27.10.2016 “Metodika e Inspektimit të veprimtarisë së sipërmarrësve të rrjeteve dhe të shërbimeve të komunikimeve elektronike”.

II. Në aspektin e trajtimit në thelb të çështjes:

1. Me Autorizim të Përgjithshëm Nr.U524-8-2, datë 01.04.2014, z.Arsen Shahaj është çertifikuar si sipërmarrës për ofrimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike, vlefshmëria e të cilit vazhdon.

2. z.Arsen Shahaj, në pozicionin e përfaqësuesit ligjor, bën më dije se nuk ka asnjë të pajtuar dhe nuk ka akoma lidhjen e interkoneksionit, por ndërkohë nuk ka paraqitur pranë AKEP asnjë kërkesë për ç regjistrim, duke mbetur efektivisht në pozicionin e sipërmarrësit, si ofrues shërbimesh i komunikimeve elektronike me të gjitha detyrimet që passjell ky status.
3. Lidhur me pretendimin se raportet e sigurisë për vitet 2016-2017 janë sjellë, grupi i inspektimit ka argumentuar se nuk janë dërguar konform Rregullores Nr.37 datë 27.10.2015 “Mbi masat teknike dhe organizative për të garantuar sigurinë dhe integritetin e rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike”.
4. Raporti nuk është i plotë dhe nuk përfshin elementet e përcaktuar nga Aneksi 3 i Rregullores dhe nga neni 6 "Detyrimet e Sipërmarrësve".

Në raport nuk gjendet informacion mbi:

- Sigurinë fizike të ambienteve dhe aseteve tuaja;
 - Sigurinë e rrjeteve, sistemeve dhe aplikacioneve mbështetëse;
 - Sigurinë dhe mbrojtjen e të dhënave personale në ruajtje, procesim dhe transmetim;
 - Rolet dhe përgjegjësitë e punonjësve që merren me çështjet e sigurisë;
 - Politikat e aksesit të kontrollit;
 - Politika e trajtimit dhe reagimit ndaj incidenteve të sigurisë;
 - Regjistër ose regjistra të shkeljeve ose incidenteve të sigurisë ku specifikohet shkelja, kategorizimi i saj, shkaku, pasoja, masat e ndërmarra etj sipas pikës 7 të nenit 6.
5. Pas komunikimit me e-mail te procesverbalit të inspektimit, z.Arsen Shahaj, ky i fundit nuk ka dërguar kontestime.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Në mbështetje të procedurës së përcaktuar në nenin 136 të ligjit nr. 44/2015 dhe , dhe në rrespektim të afatit të përcaktuar në nenin 140 të këtij ligji, nenit 132 e vijues të ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe në pikën 3.9 të Rregullores Nr.46, datë 27.10.2016 “Metodika e Inspektimit të veprimtarisë së sipërmarrësve të rrjeteve dhe të shërbimeve të komunikimeve elektronike”, aktin administrativ, Vendim Përfundimtar të Inspektimit nr.15, datë 27.02.2017 e gjen të bazuar ligjërisht.

V E N D O S:

1. Lënien në fuqi të vendimit përfundimtar të grupit të inspektimit. nr.15, datë 27.02.2017.
2. Të njoftohet sipërmarrësi Arsen Shahaj, person fizik, sipas nenit 147 e vijues të ligjit nr. 44/2015 për veprimin administrativ dhe vendimin e AKEP lidhur me ankimin administrativ.

3. Ky vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP: www.akep.al;
4. Ankimuesi, kundër këtij vendimi mund ti drejtohet Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë sipas procedurës dhe afatit të përcaktuar në ligjin nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatave Administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

Ky Vendim hyn në fuqi datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R I
Piro XHIXHO

ANËTARË:

1. Alban KARAPICI
2. Anila DENAJ
3. Ketrin TOPÇIU
4. Klarina ALLUSHI